



UNIVERSITETI BUJQËSOR I TIRANËS
BORDI ADMINISTRIMIT

Nr. 3662/Prot

Tiranë, më 16.12.2024

V E N D I M

Nr. 48, datë 16.12.2024

“PËR MIRATIMIN E LISTËS SË STUDENTËVE QË PËRFITOJNË BURSË FINANCIARE DHE QË PËRJASHTOHEN NGA TARIFA E SHKOLLIMIT ME 100% NË PROGRAMET E CIKLIT TË PARË TË STUDIMEVE, NË NJË PROGRAM TË INTEGRUAR TË STUDIMEVE OSE NË NJË PROGRAM TË STUDIMEVE PROFESIONALE, PËR VITIN AKADEMIK 2024– 2025, (raste të veçanta, faza e parë)”

Bordi i Administrimit, mbështetur në Ligjin Nr. 80/2015, datë 22.7.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, VKM nr. 903, datë 21.12.2016 "Për përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave nga fondi i mbështetjes studentore, për studentët e shkëlqyer, studentët që studiojnë në programe studimi në fushat prioritare dhe studentët në nevojë", ndryshuar me VKM nr.784, datë 26.12.2018 dhe VKM nr. 39, datë 23.01.2019, si dhe referuar kërkesës së Administratorit të UBT-së me Nr. 3662 Prot., datë 16 .12.2024 në mbledhjen e tij të datës 16.12.2024,

V E N D O S I:

1. Të miratojë listën e studentëve që përfitojnë bursë financiare dhe që përjashtohen nga tarifa e shkollimit me 100 % në një program të ciklit të parë të studimeve, në një program të integruar të studimeve ose në një program të studimeve profesionale, për vitin akademik 2024-2025.
 2. Efektet financiare për 5 (pesë) studentë që përfitojnë bursë dhe që përjashtohen 100% nga tarifa e studimit janë në total 580,000 (*pesëqind e tetëdhjetë mijë*) lekë, përkatësisht:
 - a.) Bursat, në vlerën 450,000 (*katërqind e pesëdhjetë mijë*) lekë.
 - b.) Përjashtimi 100% nga tarifa e studimit në vlerën 130,000 (*njëdyqind e tridhjetë mijë*) lekë.
 3. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Administratori i UBT-së.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

BORDI I ADMINISTRIMIT

Arta **DOLLANI**
Sokol **DURO**

Kryetar
Anëtar



Blerina DUKA
Donika KËRÇINI
Florian NURCE
Altin PRENGA
Albert KOPALI

Anëtar

Anëtar

Anëtar

Anëtar

Anëtar

Konceptoi: N. Ndoci